

THIRRJE PËR PRAKTIKA PROFESIONALE

Rritja e aftësive dhe mundësive të punësimit për studentët romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë

Rreth Roma Versitas Kosovo

Roma Versitas Kosovo është organizata e vetme që punon kryesisht me studentët Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në të gjithë Kosovën, në baza ditore. Për më shumë se pesë vjet, RVK ka qenë e përkushtuar për të mbështetur studentët romë, ashkali dhe egjiptianë nga regjistrimi deri në diplomim, duke lehtësuar gjithashtu kalimin e tyre në tregun e punës. Përmes një game të gjerë mundësish për zhvillim akademik, personal dhe profesional, RVK fuqizon studentët të arrijnë sukses dhe të bëhen kontribuues aktivë në zhvillimin e Kosovës dhe të ardhmen e komuniteteve të tyre. Me një rrjet të stafit në gjithë Kosovën dhe një komunitet aktiv të ish-studentëve, ndikimi i RVK-së tashmë shtrihet përtej qendrave fillestare në Prishtinë, Prizren dhe Pejë. Organizata vazhdon të zgjerohet duke ofruar mbështetje dhe angazhim të drejtpërdrejtë nëpër komuna për të siguruar përparim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Rreth projektit

Ky projekt synon të ndërtojë mirëkuptim politik dhe institucional mbi rëndësinë e rolit të institucioneve publike në krijimin e mundësive të barabarta për punësim për të diplomuarit Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, si dhe të ofrojë studentëve një përvojë direkte me punën e institucioneve.

Koncepti do të trajtojë tre fusha kryesore tematike të rëndësishme për një qasje cilësore ndaj punësimit të studentëve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë:

- a) Qasja në arsim cilësor dhe udhëzim në karrierë;
- b) Rritja e aftësive dhe mundësive të punësimit për studentët e universiteteve romë, ashkali dhe egjiptianë

Qëllimi i projektit është të punojë me tetë studentë; Barazia gjinore dhe diversiteti komunitar në mesin e përfituesve të praktikave do të sigurohen përmes qasjes gjithëpërfshirëse, kriterëve të balancuara të përzgjedhjes dhe angazhimit aktiv me grupet e nënpërfaqësuar.

Praktikantët mund të angazhohen në institucione qendrore si Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Zyra për Qeverisje të Mirë, apo në trupa të tjera relevante qeveritare. Institucioni pritës do të zgjidhet në bashkëpunim me çdo praktikant, duke u dhënë përparësi mundësive të tyre për mësim dhe kontribut që ata mund të japin bazuar në interesat dhe përvojën e tyre të mëparshme.

Kohëzgjatja

Procesi i zhvillimit profesional, mentorimit të praktikantëve dhe monitorimit të praktikave do të zgjasë shtatë muaj, duke përfshirë trajnimin dhe raportimin. Kohëzgjatja e praktikës do të jetë pesë muaj, ku angazhimi minimal i prituri është 14 ditë pune në muaj.

Kritere pranimi

Përparësi do t'u jepet studentëve që janë në përfundim të studimeve dhe atyre që kanë diplomuar së fundmi. Megjithatë, të gjithë studentët Romë, Ashkali dhe Egjiptianë inkurajohen të aplikojnë.

Aftësi të kërkuara

Të demonstrojnë interes të fortë për rritje personale dhe profesionale, aftësi për të menaxhuar detyra të shumta në mënyrë efektive, vëmendje të madhe ndaj detajeve, dhe gatishmëri për të ndarë aktivisht njohuritë dhe aftësitë e fituara me bashkëmoshatarët dhe komunitetin.

I) DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Dokumentet e mëposhtme duhet të dërgohen në **romaversitaskosovo@gmail.com**:

1. CV;
2. Diploma universitare, nëse kandidati ka përfunduar studimet;
3. Vërtetim që student është i regjistruar në universitet, nëse ende nuk ka diplomuar;
4. Letër motivimi (maksimumi 1 faqe);
5. Certifikata të trajnimeve përkatëse, nëse ka përfunduar ndonjë;
6. Të paktën dy referenca kontakti (Email/Telefon në lidhje me aplikuesin);

II) AFATI I DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Afati për aplikim është i hapur deri më **9 maj 2025, ora 16:00**. Aplikimet e dorëzuara pas këtij afati nuk do të merren parasysh.

Kandidatët do të vlerësohen sipas numrit të përgjithshëm të pikëve të ndara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje.



Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të thirren për intervistë.

Nëse komisioni vërteton se ndonjë kandidat ka dorëzuar dokumente të pavlefshme ose të falsifikuara, ai/ajo do të përjashtohet automatikisht.

III) KOMPENSIMI GJATË PRAKTIKËS

Gjatë periudhës së angazhimit, praktikantët do të marrin një kompensim mujor prej **250 euro**. Kjo shumë ka për qëllim të mbulojë shpenzimet bazë që lidhen me praktikën, duke përfshirë ushqimin dhe shpenzime të tjera të vogla që mund të dalin gjatë pjesëmarrjes në program.

Për më shumë informacion mund të telefononi në 049/26 86 00, 048/79 40 60 ose të vizitoni faqen zyrtare të Roma Versitas Kosovo: www.romaversitaskosovo.com

Ky projekt mbështetet nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.